


Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Maj 2021

Tiranë, më 08 Qershor 2021: Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Maj 2021, arriti 102,4 kundrejt muajit Dhjetor 2020.

Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Maj 2021 është 1,8 %, një vit më parë ky ndryshim ishte 2,1 %. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Maj 2021, krahasuar me Prill 2021 është -0,9 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)




Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit.

Rritja vjetore e çmimeve në muajin Maj është ndikuar kryesisht nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +1,26 pikë përqindje, pasuar nga grupi “Transporti” me +0,11 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Komunikimi” kanë kontribuar me +0,09 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” kanë kontribuar me +0,07 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” kanë kontribuar me +0,06 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Pije alkoolike dhe duhan”, “Argëtim dhe kulturë”, “Hotele, kafene dhe restorante” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” kanë kontribuar me +0,05 pikë përqindje secili. Çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” kanë kontribuar me +0,04 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Shëndeti” kanë kontribuar me +0,02 pikë përqindje.

Për publikim 08/06/2021

Fig.2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Maj 2020, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 3,7 %, pasuar nga grupet “Komunikimi” me 2,8 %, “Transporti” me 2,2 %, “Pije alkoolike dhe duhan” me 1,5 %, “Argëtim dhe kulturë” me 1,4 %, “Hotele, kafene dhe restorante” me 1,1 %, “Veshje dhe këpucë” me 1,0 %, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 0,9 %, “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0,8 %, “Shëndeti” me 0,5 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 0,3 % dhe “Shërbimi arsimor” me 0,1 %.

Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “zarzavate përfshirë patatet” u rritën me 10,1 %, pasuar nga nëngrupet “vajra dhe yndyrna” me 6,2 %, “fruta” me 4,0 %, “peshk” me 2,5 %, “qumësht, djathë dhe vezë” me 1,8 %, “mish” me 1,5 %, etj.

Ndryshimet mujore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Prill 2021, çmimet e grupit “Ushqime dhe pije joalkoolike” u ulën me 2,8 %, pasuar nga grupet “Argëtim dhe kulturë” me 0,3 % dhe “Pije alkoolike dhe duhan” me 0,1 %. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Transporti” u rritën me 1,2 %, pasuar nga grupet “Shëndeti” me 0,4 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 0,2 %, “Veshje dhe këpucë”, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë”, “Hotele, kafene dhe restorante” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0,1 % secili.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2020=100

Kodi	Grupet	Peshat	05-20	06-20	07-20	08-20	09-20	10-20	11-20	12-20	01-21	02-21	03-21	04-21	05-21
	Gjithsej	100	100,5	99,9	99,4	99,6	100,0	100,2	99,7	100,0	101,3	102,4	103,0	103,3	102,4
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	34,9	101,5	100,0	98,6	99,0	100,1	100,7	99,3	100,0	103,0	106,1	107,8	108,3	105,2
2	Pije alkoolike dhe duhan	3,8	99,8	99,9	99,9	100,0	99,7	99,7	99,9	100,0	100,8	101,2	101,3	101,4	101,3
3	Veshje dhe këpucë	4,3	99,3	99,6	99,5	99,3	99,3	99,6	99,9	100,0	100,1	99,8	100,0	100,2	100,3
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	19,7	100,1	100,0	99,9	100,0	100,0	100,1	99,9	100,0	100,1	100,2	100,2	100,2	100,4
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	7,9	99,9	99,9	99,6	100,1	99,7	99,9	99,8	100,0	100,7	100,9	101,1	100,6	100,7
6	Shëndeti	3,5	100,1	100,2	100,2	100,2	100,1	100,0	100,0	100,0	101,0	101,0	100,9	100,3	100,6
7	Transporti	5,3	100,2	100,1	100,2	100,7	100,5	100,1	99,8	100,0	100,2	100,8	101,0	101,2	102,4
8	Komunikimi	3,1	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,1	100,0	100,0	100,0	101,4	102,8	102,8
9	Argëtim dhe kulturë	3,4	100,1	100,9	100,0	100,1	100,1	99,9	100,2	100,0	100,6	100,1	99,7	101,8	101,5
10	Shërbimi arsimor	3,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,1	100,1	100,1	100,1	100,2
11	Hotele, kafene dhe restorante	4,0	99,7	99,7	99,7	99,7	99,8	100,0	100,0	100,0	100,6	100,7	100,7	100,7	100,8
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	7,2	99,3	99,4	99,7	99,7	100,0	100,1	100,1	100,0	100,2	99,9	99,8	100,0	100,1

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	05-20/05-19	06-20/06-19	07-20/07-19	08-20/08-19	09-20/09-19	10-20/10-19	11-20/11-19	12-20/12-19	01-21/01-20	02-21/02-20	03-21/03-20	04-21/04-20	05-21/05-20
	Gjithsej	2,1	1,8	1,4	1,3	1,5	2,0	1,6	1,1	0,4	1,1	1,2	1,9	1,8
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	4,9	4,1	3,1	3,1	3,8	4,9	3,9	2,5	1,2	3,2	3,1	4,5	3,7
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,6	0,6	0,7	0,6	0,4	0,3	0,6	0,9	1,1	1,4	1,3	1,7	1,5
3	Veshje dhe këpucë	-0,7	-0,5	-0,2	-0,2	-0,7	-0,8	-0,6	-0,6	-0,4	-0,6	0,2	0,4	1,0
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	1,4	1,4	1,4	1,5	1,5	1,5	1,3	1,2	-0,1	0,0	0,1	0,1	0,3
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	1,9	2,0	1,8	1,9	1,3	1,5	1,2	1,2	2,0	2,2	2,2	0,6	0,9
6	Shëndeti	-0,6	-0,6	-0,2	-0,2	-0,4	-0,4	-0,3	-0,2	0,9	1,1	0,7	0,1	0,5
7	Transporti	-3,7	-4,0	-4,8	-5,8	-4,6	-4,3	-4,6	-4,9	-4,7	-3,9	-1,6	0,3	2,2
8	Komunikimi	0,4	0,4	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,5	0,7	0,7	2,2	3,6	2,8
9	Argëtim dhe kulturë	2,7	2,9	1,4	0,0	-0,4	-0,3	0,9	0,5	1,7	0,4	0,1	1,3	1,4
10	Shërbimi arsimor	0,2	0,2	0,2	0,2	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	0,1
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,7	0,5	0,5	0,6	0,6	0,8	0,7	0,7	1,0	1,0	1,1	1,0	1,1
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,3	0,3	0,6	0,6	0,9	0,9	0,9	0,7	0,9	0,6	0,5	0,8	0,8

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	05-20	06-20	07-20	08-20	09-20	10-20	11-20	12-20	01-21	02-21	03-21	04-21	05-21
	Gjithsej	-0,8	-0,6	-0,5	0,2	0,4	0,2	-0,5	0,3	1,3	1,1	0,7	0,2	-0,9
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	-2,1	-1,5	-1,3	0,4	1,0	0,6	-1,3	0,7	3,0	3,0	1,6	0,4	-2,8
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,1	0,1	0,1	0,1	-0,3	-0,1	0,3	0,1	0,8	0,4	0,1	0,1	-0,1
3	Veshje dhe këpucë	-0,5	0,3	0,0	-0,3	0,0	0,3	0,4	0,1	0,1	-0,4	0,3	0,2	0,1
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,0	-0,2	0,0	0,1	0,0	0,1	-0,2	0,1	0,1	0,1	0,0	0,0	0,2
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	-0,1	0,0	-0,2	0,5	-0,4	0,2	0,0	0,2	0,7	0,2	0,2	-0,5	0,1
6	Shëndeti	0,0	0,0	0,0	0,0	-0,1	-0,1	0,0	0,0	1,0	0,1	-0,1	-0,6	0,4
7	Transporti	-0,7	-0,1	0,1	0,5	-0,2	-0,4	-0,3	0,2	0,2	0,6	0,2	0,1	1,2
8	Komunikimi	0,8	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	-0,1	0,0	0,0	1,4	1,3	0,0
9	Argëtim dhe kulturë	-0,4	0,8	-0,9	0,1	0,0	-0,2	0,3	-0,2	0,6	-0,6	-0,4	2,1	-0,3
10	Shërbimi arsimor	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	0,0	0,0	0,1	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	0,2	0,0	0,0	0,6	0,1	0,0	0,0	0,1
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,1	0,1	0,3	0,0	0,3	0,0	0,0	-0,1	0,2	-0,2	-0,2	0,2	0,1

Metodologjia

Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2018.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga 331 produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mbledhen çmimet.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit duke filluar nga muaji Janar 2021 do të llogaritet me bazën e re. Muaji Dhjetor 2020 do të shërbejë si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (Dhjetor 2020 = 100).

INSTAT gjatë periudhës së Pandemisë ka ndjekur rekomandimet më të fundit metodologjike të EUROSTAT dhe të partnerëve të tjerë ndërkombëtarë.

Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri, Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm, Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.